



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 4 dhjetor 2025

Lënda nr. 2025-01

Ilir Olloni

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ("Paneli") i mbledhur më 4 dhjetor 2025 ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Marina MANCINI, ushtruese e detyrës së kryesueses
Z. Petko PETKOV, anëtar

Ndihmuar nga:
Znj. Pia HOLM, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 6 korrik 2023.

Pasi shqyrtoi përmes mjeteve elektronike në përputhje me rregullin 13(3) të rregullores së punës së Panelit, vendos si më poshtë:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua përmes postës më 10 mars 2025 dhe u regjistrua më 13 mars 2025.
2. Më 23 mars, Paneli kërkoi informacione shtesë nga ankuesi në lidhje me dokumentet e listuara në ankesë, të cilat nuk ishin bashkëngjitur, dhe çfarëdo kundërshtimi për publikimin e emrit të tij, duke marrë parasysh kërkesën e tij për ta mbajtur identitetin e tij konfidencial në procedurat që lidhen me një ankesë të mëparshme të paraqitur në vitin 2014.

3. Më 14 prill, ankuesi paraqiti dokumentet e listuara në ankesë dhe konfirmoi se nuk kishte kundërshtim që emri i tij të bëhej publik gjatë procedurave të tanishme.

II. THE FACTS

4. Ankuesi pretendon se një neuropsikiatër ka shfrytëzuar familjen e tij për qëllime biznesi, duke përdorur mjete të sofistikuar kibernetike, që nga viti 1998-1999.
5. Ankuesi gjithashtu pretendon se neuropsikiatri i lartpërmendur ka dëmtuar pronën e familjes së tij dhe ka ushtruar dhunë fizike ndaj tij, në bashkëpunim me individë të tjerë. Ai pohon se që nga viti 2001, dhuna ndaj tij ka qenë e vazhdueshme dhe është intensifikuar me kalimin e kohës.
6. Ankuesi pohon se e ka raportuar vazhdimisht sjelljen e neuropsikiatrit në polici; megjithatë, ata nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Ai i ka siguruar Panelit ankesat e paraqitura në Zyrën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë në vitin 2016 dhe 2017, së bashku me një kërkesë të bërë në vitin 2020 në Gjykatën Themelore në Gjakovë për qasje në dosjet e tij të lëndës.
7. Neuropsikiatri në fjalë është i njëjti individ, sjellja e të cilit ishte në qendër të ankesës së paraqitur në vitin 2014, të cilën Paneli e shpalli të papranueshme.

III. ANKESA

8. Ankuesi kërkon që EULEX-i Kosovë të sigurojë funksionimin e duhur të policisë vendore dhe që atij t'i ofrohen të njëjtat të drejta si banorëve të tjerë të qytetit të tij.

IV. LIGJI

9. Para shqyrtimit të ankesës në lidhje me meritat e saj, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh rregullin 29(1) të rregullores së tij të punës. Kjo dispozitë thekson se Paneli mund të shpall një ankesë të papranueshme në procedura të shkurtuara, *ndër të tjera*, nëse ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit.
10. Sipas rregullës 25(1) të rregullores së punës, juridiksioni i Panelit është i kufizuar në ankesat që kanë të bëjnë me shkelje të dyshuara të të drejtave të njeriut nga Misioni gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Mandati ekzekutiv i Misionit është përcaktuar në nenin 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit të BE-së 2008/124/CFSP, siç është ndryshuar nga Vendimi i Këshillit të BE-së (CFSP) 2018/856.
11. Paneli konsideron se ankuesi nuk demonstroi ose argumenton se EULEX-i Kosovë është përfshirë në ndonjë veprim që dyshohet se është kryer ndaj tij, e

Misioni as nuk mban ndonjë përgjegjësi për mosveprimin e autoriteteve kompetente vendore.

12. Paneli konstaton se pretendimet e bëra nga ankuesi nuk lidhen me mandatin ekzekutiv të Misionit. Vendimet në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve bien tërësisht brenda kompetencës së autoriteteve të Kosovës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë fushës së juridiksionit të tij, sipas rregullave 25(1) dhe 29(1)(d) të rregullores së tij të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Marina MANCINI,
Ushtruese e detyrës së kryesueses



Petko PETKOV,
Anëtar